



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA KOMBËTARE E RINISË  
DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 107/4 Prot.

Tiranë, më 03.04. 2026

**SHPLLJEN E THIRRJES PËR APLIKIM SI ANËTAR EKSPERT ME PROFIL  
INXHINIER CIVIL DHE ME PËRVOJË NË ZBATIMIN DHE/OSE SUPERVIZIMIN  
E PROJEKTEVE TË VOGLA INFRASTRUKTURE NË KOMISIONIN E  
VLERËSIMIT TË PROJEKTPROPOZIMEVE TË BASHKIVE**

Bazuar në Ligjin Nr. 75/2019 “Për Rininë”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 566 datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së Organizatave Rinore dhe/ose Për Të Rinjtë, që përfitojnë financim nga fondet grant nga buxheti i shtetit të dedikuar për rininë”, i ndryshuar dhe Vendimin Nr. 196, date 26.3.2026 “Për Përcaktimin e Rregullave për Organizimin, Funkcionimin dhe Përbërjen e Komisionit të Vlerësimit, si dhe të Kriterëve, Procedurave të Përzgjedhjes e të Shpërblimit të Anëtarëve të tij”, Agjencia Kombëtare e Rinisë shpall thirrjen për aplikim si antarë ekspert me profil inxhinier civil dhe me përvojë në zbatimin dhe/ose supervizimin e projekteve të vogla infrastrukturore në Komisionin e Vlerësimit të projektpropozimeve të paraqitura nga Bashkitë në Thirrjen V të AKR-së.

**Procesi i përzgjedhjes së aplikantëve:**

Procesi i përzgjedhjes së antarit ekspert me profil inxhinier civil dhe me përvojë në zbatimin dhe/ose supervizimin e projekteve të vogla infrastrukturore në Komisionin e Vlerësimit të projektpropozimeve do të menaxhohen nga Agjencia Kombëtare e Rinisë dhe do të bazohet në një proces të hapur konkurrimi. Përzgjedhja e aplikantëve do të bazohet mbi vlerësimin e kushteve dhe kriterëve të shpallura në këtë thirrje.

Bazuar në Kreun II. “Përbërja e Komisionit të Vlerësimit, Kriteret dhe Proce-Dura e Përzgjedhjes së Anëtarëve” pika 8 të Vendimit Nr. 196, date 26.3.2026 “Për Përcaktimin e Rregullave për Organizimin, Funkcionimin dhe Përbërjen e Komisionit të Vlerësimit, si dhe të Kriterëve, Procedurave të Përzgjedhjes e të Shpërblimit të Anëtarëve të tij”:

*AKR-ja harton termat e referencës dhe shpall thirrjen e konkurrimit për ekspertët, brenda 7 (shtatë) ditëve kalendarike nga shpallja e thirrjes publike për mbështetje përmes fondeve grant të buxhetit të shtetit, të dedikuara për rininë. **Thirrja publikohet në faqen e internetit të institucionit dhe qëndron e hapur për të paktën 10 (dhjetë) ditë.***

Bazuar në Kreun II. “Përbërja e Komisionit të Vlerësimit, Kriteret dhe Proce-Dura e Përzgjedhjes së Anëtarëve” pika 10 të Vendimit Nr. 196, date 26.3.2026 “Për Përcaktimin e Rregullave për Organizimin, Funkcionimin dhe Përbërjen e Komisionit të Vlerësimit, si dhe të Kriterëve, Procedurave të Përzgjedhjes e të Shpërblimit të Anëtarëve të tij”:

*AKR-ja bën shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit të kandidatëve dhe, **brenda 5 (pesë) ditëve nga përfundimi i thirrjes së konkurrimit për ekspertë, sipas rastiit, shpall fitues:***

b) **kandidatin** e vlerësuar me pikët më të larta, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të përcaktuar në nënndarjen “iii”, të shkronjës “b”, të pikës 1, të këtij kreu; në rast të krijimit të vakancës, eksperti i parë zëvendësohet nga një 1 (një) kandidat i renditur menjëherë pas tij.

### **Kriteret e aplikimit:**

Anëtari, ekspert i komisionit të vlerësimit, i përcaktuar në nënndarjen “iii”, të shkronjës “b”, të pikës 1, të këtij kreu, duhet të plotësojë kushtet e kriteret e mëposhtme:

- a) të ketë mbaruar studimet universitare të ciklit të dytë (“Master i Shkencave” ose ekuivalent), për inxhinieri civile;
- b) të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- c) të ketë mbi 10 (dhjetë) vjet përvojë pune;
- ç) të ketë përvojë në projektimin, zbatimin dhe/ose supervizimin e projekteve infrastrukturore të financuara me fonde publike.

### **Procesi i aplikimit**

Kandidatët e interesuar për pozicionin e ekspertit në komisionin e vlerësimit duhet të dorëzojnë me email në adresën [info@rinia.gov.al](mailto:info@rinia.gov.al) dokumentacionin, si vijon:

- a) jetëshkrimin;
- b) kopje të dokumentit të identifikimit;
- c) letërmotivimin;
- ç) vetëdeklarimin për vërtetësinë e të dhënave;
- d) kopjen e diplomës universitare;
- dh) dëshminë e penalitetit.

### **Afati i aplikimit:**

Afati përfundimtar i dorëzimit të aplikimit është data **16.04.2026**.

### **Periudha e zbatimit të detyrave:**

Bazuar në Kreun III. “Organizimi, Funksionimi dhe Detyrat e Komisionit të Vlerësimit, Rastet e Mbarimit të Mandatit dhe të Lirimit nga Detyra të Anëtarëve”, pika 11 të Vendimit Nr. 196, date 26.3.2026 “Për Përcaktimin e Rregullave për Organizimin, Funksionimin dhe Përbërjen e Komisionit të Vlerësimit, si dhe të Kriterëve, Procedurave të Përzgjedhjes e të Shpërblimit të Anëtarëve të tij”:

Mandati i anëtarit të komisionit të vlerësimit fillon me aktin e emërimit dhe përfundon me përfundimin e plotë të procedurës së vlerësimit për thirrjen publike përkatëse, përfshirë miratimin e listës përfundimtare të projekteve të përzgjedhura për financim.

### **Informacion shtesë:**

Angazhimi i anëtarit ekspert nga shoqëria civile në Komisionin e Vlerësimit të projektpropozimeve të paraqitura nga organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë do të realizohet bazuar në Kreun IV. “Masa Shpërblimit”, të Vendimit Nr. 196, date 26.3.2026

*“Për Përcaktimin e Rregullave për Organizimin, Funkcionimin dhe Përbërjen e Komisionit të Vlerësimit, si dhe të Kritereve, Procedurave të Përzgjedhjes e të Shpërblimit të Anëtarëve të tij” . Anëtari ekspert me profil inxhinier civil dhe me përvojë në zbatimin dhe/ose supervizimin e projekteve të vogla infrastrukturore në Komisionin e Vlerësimit ushtron detyrën në përputhje me kuadrin rregullator të miratuar për thirrjen dhe i nënshtrohet detyrimeve ligjore të përcaktuara për konfliktin e interesit dhe konfidencialitetit të dhënave gjatë gjithë procesit.*

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Sara Bodo**

